

CELIM SHQIPËRI

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 28.07.2011
- Statusi Ligjor: Organizatë jofitimprurëse
- Selia Qendrore: Shqipëri, Vlorë, Bulevardi Ismail Qemali Nr.88, H.4, Ap.7
- Faqja e Internetit: www.celim.it
- Email kryesor i organizatës: albania@celim.it
- Telefoni kryesor i organizatës: +355694307048

2. Misioni

CELIM Shqipëri është një organizatë jo-fitimprurëse që vepron për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen sociale, duke fuqizuar komunitetet përmes arsimit, mbrojtjes së mjedisit dhe nismave ekonomike. Misioni i saj “Impact to change” pasqyron synimin për të sjellë ndryshime të qëndrueshme dhe domethënëse në jetën e njerëzve

3. Vizioni (Opsionale)

Vizioni i CELIM Shqipëri është ndërtimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, ku çdo individ, veçanërisht ata në situata vulnerabël, ka mundësi reale për të zhvilluar potencialin e vet dhe për të kontribuar në mirëqenien e komunitetit dhe në mbrojtjen e mjedisit.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

Një listë ose përshkrim i shkurtër i sektorëve ose fushave kryesore të punës së organizatës.

- Mbrojtja e Mjedisit – promovimi i praktikave ekologjike dhe ruajtja e burimeve natyrore.
- Zhvillimi i Komunitetit – fuqizimi i komuniteteve lokale përmes arsimit, trajnimeve dhe mbështetjes sociale.
- Zbutja e Ndryshimeve Klimatike – nxitja e iniciativave për adaptim dhe përgjegjësi ndaj klimës.
- Advokimi për Politika – përkrahja e ndryshimeve ligjore dhe politike që mbrojnë të drejtat e komuniteteve vulnerabël.
- Arsimi dhe Trajnimi Profesional – ofrimi i mundësive për edukim dhe aftësim profesional.
- Përfshirja Sociale – integrimi i grupeve në nevojë dhe promovimi i barazisë gjinore dhe sociale.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

CELIM SHQIPËRI

Titulli i projekti/fushatës	Përshkrim i shkurtër dhe kohëzgjatja	Donator i projektit	Vlera e administruar
APN2000 Veprimi I përbashkër i OShCve për Promovimin e Rrjetit Natura2000 në Shqipëri	30 muaj APN2000 synon të rrisë kapacitetet e Organizatave lokale të Shoqërisë Civile Mjedisore (OCSO) dhe Grupeve Vendore të Veprimit (GLV) në përmirësimin e veprimeve të mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së biodiversitetit në Gjirin e Vlorës nga Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë deri në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan.	Delegacioni i Bashkimi European	325.559 euro
VITA-Vjosa: Rritja e nismave të turizmit mjedisor përgjatë basenit të lumit Vjosë	36 muaj Dhënia e kontributit në rritjen e punësimit e NMV ndërmarrje të vogla të mesme, që operojnë në sektorin e turizmit të përgjegjshëm në Shqipëri përgjatë basenit të lumit Vjosa	AICS (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim)	655.013,71 euro

CELIM SHQIPËRI

Tourism to Change	12 muaj Rritja e kapaciteteve të të rinjve të papunë NEET në Memaliaj, me përparësi gjinisë femërore, për t'u punësuar në qendrat e vizitorëve për menaxhimin dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm në pellgun e lumit Vjosa	Partnerët Shqiptar për Ndryshim dhe Zhvillim në kuadër të Projektit TËIST implementuar sëbashku me Libera contro le Mafie dhe Bashkia Tiranë	11.600 euro
BLUE CoaAL-Ition: zhvillimi i qendrueshëm i pasurisë natyrore të bregdetit shqiptar	30 muaj Forcimi i rolit të institucioneve shqiptare, kombëtare dhe rajonale, dhe komuniteteve lokale për menaxhimin e zonave të karakterizuar nga basene ujore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, nëpërmjet zhvillimit të aspekteve historike, kulturore dhe tradicionale të turizmit të qëndrueshëm	AICS (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim)	289.446 euro

CELIM SHQIPËRI

GREEN CoaAL-Ition: zhvillimi i qendrueshëm i pasurisë natyrore në tokën e brendshme shqiptare	30 muaj Forcimi i rolit të institucioneve shqiptare, kombëtare dhe rajonale, dhe komuniteteve lokale për menaxhimin e zonave të karakterizuar nga basene ujore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, nëpërmjet zhvillimit të aspekteve historike, kulturore dhe tradicionale të turizmit të qendrueshëm	AICS (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim)	23.263.,80 euro
Project title: VaLORË GREEN – Një model kompanie në pronësi të bashkisë për shërbimet mjedisore dhe rehabilitimin dhe ruajtjen e zonave natyrore të Bashkisë së Vlorës	24 muaj Në kuadër të bashkëpunimit “Qytet me Qytet Vlorë-Milano” dhe në përputhje me prioritetin “e” të Thirrjes për Propozime IADSA II, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë së Vlorës duke strukturuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, bazuar në përgjegjësinë sociale	IADSA	60.795,96 euro

CELIM SHQIPËRI

	dhe përgjegjësinë mjedisore.		
ACAP (Aksioni Komunitar për ruajtjen e Zonave të Mbrojtura)	42 muaj Në rrugën e aderimit të Shqipërisë në Rrjetin evropian Natura 2000, objektivi është dhënia e kontributit për ruajtjen e Zonave të Mbrojtura në të cilat shtrihet projekti dhe fuqizimi i masave të menaxhimit dhe ruajtjes së parqeve	AICS (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim)	1.154.949 euro

6. Shtrirja Gjeografike

CELIM Shqipëri operon kryesisht në Shqipërinë e Jugut, me projekte aktive në qarqet e Vlorës, Gjirokastrës. Aktivitetet janë përqendruar në bashkitë e Vlorës, Mallakastër, Memaliaj, Selenicës, Tepelenës, Këlcyrës, Përmetit, Gjirokastrë, Dropull si dhe në zona me rëndësi mjedisore si lugina e Vjosës, Parku Kombëtar i Llogarasë dhe peizazhi i mbrojtur Vjosa–Nartë.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Gerta Mehmeti Përfaqësuese Ligjore
Bordi i Drejtuesve: CELIM Milano

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

CELIM Shqipëri ka zhvilluar partneritete të rëndësishme me institucione publike vendore si bashkitë e Vlorës, Memaliaj, Këlcyrës, Përmetit, Dropullit, si dhe me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ADZM). Ndër donatorët dhe bashkëpunëtorët kryesorë përfshihen Bashkimi Evropian, AICS (Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim), si dhe organizata ndërkombëtare e lokale që veprojnë në fushat e mjedisit, turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit social.

CELIM SHQIPËRI

9. Ndikimi (Opsionale)

Në dy vitet e fundit 2023-2024 me projektet tona ndër shumë të tjera janë arritur këto rezultate:

- 1 studim hidrogeologjik në deltën e lumit Vjosa;
- 1 studim mbi habitatin detar të zonës së Porto Palermo;
- 1 raport mbi ekonominë dhe bizneset në Porto Palermo dhe Himarë;
- 1 model shkencor mbi ekuilibrin hidrodinamik të lagunës së Nartës dhe menaxhimin korrekt natyror dhe ekonomik të saj;
- 1 tryezë e rrumbullakët mbi shtigjet e rrjetit të zonave të mbrojtura në parkun kombëtar të lumit Vjosa;
- 7 takime për trajnime të SME-ve që punojnë në fushën e turizmit në 7 bashki përgjatë lumit Vjosa (Memaliaj, Mallakaster, Tepelena, Permet, Kelcyre, Vlora, Selenica);
- 9 përfaqësues të bizneseve të vogla janë trajnuar në lidhje me mundësitë e aplikimit për grante të vogla dhe financim të teknologjive RES në kuadër të projektit VITA Vjosa;
- 1 qendër rekuperimi për breshkat detare ndërtuar në zonën e Vlorë;
- 41 kit për menaxhimin mjedisor janë shpërndarë për administratat rajonale të zonave të mbrojtura të rajonit jugor;
- 2 trajnime 2 javor mbi birdwatching për guida lokale është realizuar;
- 2 trajnim për peshkatarë mbi peshkimin e përgjegjshëm është realizuar.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

N/A